

Ministria e Financave

Gazeta Express kërkon listën e aplikimeve të medimeve për përfitime në Pakon Emergjente të hartuar nga Ministria e Financave. Ky medium kërkon të dijë se cilat medime kanë aplikuar deri më 10 maj dhe me çfarë metode është bërë përzgjedhja e medimeve që kompensohen të parat.

Ju lutem të na ofroni këshillë si të veprojmë me këtë kërkesë!

AIP / ShQDP

Dokumenti i kërkuar mund të konsiderohet si pjesë e dokumentacionit të prodhuar nga Ministria e Financave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj publike në menaxhimin e një situate të caktuar (siç është rasti i lancimit të pakos emergjente në kohën e pandemisë së Covid 19). Publikimi i dokumenteve të këtilla publike (qofshin edhe përmbledhje të dhënash, faktesh apo informacionesh), parashihet edhe me paragrafin 2.4 të nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Nëse Ministria e Financave nuk ka arsye të bazuar ligjore për ta mbajtur të mbyllur këtë dokument, për të njëjtin duhet ofruar qasje ndaj palës kërkuese, por pa shpalosur të dhëna personale eventuale të individëve që kanë përfaqësuar mediumet përfituese nga pakoja emergjente.

Ofrimi i qasjes në dokumentin e kërkuar arsyetohet me paragrafin 3 të nenit 17 të LQDP-së, sipas të cilit, qasja ofrohet për palën kërkuese në rastet kur dokumenti ka të bëjë me shpenzimin e parasë publike. Në këtë rast, pakoja emergjente e MF menaxhohet nga paraja publike (buxheti i shtetit).

Për më tepër, asnjëri nga nënparagrafët e paragrafit 2 të nenit 17 të LQDP-së nuk mund të aplikohet për ta kufizuar qasjen në dokumentin e kërkuar.